



Shkuarja në gjyq

Edhe gjatë pandemisë COVID-19 akoma punon Gjykata e Lartë e Australisë, Gjykata Federale e Australisë, Gjykata për çështje familjare e Australisë dhe Gjykata Federale Qarkore e Australisë.

Edhe pse të gjithë sportelet dhe shërbimet e drejtpërdrejta janë të mbyllura, secila gjykatë ka bërë përgatitjet për seancat e tanishme para gjykimit. Në rrethana urgjente, shërbimet e drejtpërdrejta mund të ofrohen pas një vlerësimi fillestar përmes telefonit.

Për informacionet dhe përditësimet më të reja vizitoni uebfaqen e gjykatës apo përdorni informacionet për kontakt në vijim:

- Gjykata e Lartë e Australisë ([High Court of Australia](#)) ose 02 6270 6811
- Gjykata Federale e Australisë ([Federal Court of Australia](#)) ose 1300 720 980
- Gjykata për çështje familjare e Australisë ([Family Court of Australia](#)) ose 1300 352 000
- Gjykata Federale Qarkore e Australisë ([Federal Circuit Court of Australia](#)) ose 1300 720 980

Gjykata Administrative e Apelit gjithashtu është duke punuar edhe pse zyrat e saj lokale momentalisht janë të mbyllura. Për më shumë informacione vizitoni uebfaqen e gjykatës ([website](#)) ose thirrni në 1800 228 333.